

20171322672

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 1

Në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 13/16 dhe 142/16), në nenin 4 paragrafi (7) fjalët: "nga mjetet nga taksa e arkëtuar radiodifuzive" zëvendësohet me fjalët: "nga mjetet për financimin e veprimtarisë radiodifuzive".

Neni 2

Në nenin 105 paragrafi (1) fjalët: "nga taksa radiodifuzive", zëvendësohen me fjalët: "mjetet për financimin e veprimtarisë radiodifuzive," dhe fjalët: "dhe nga mjetet e siguruara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin rrjedhës," shlyhen.

Paragrafi (5) shlyhet.

Neni 3

Në nenin 109 paragrafi (1) fjalët: "taksa radiodifuzive" zëvendësohen me fjalët: "mjetet për financim të veprimtarisë radiodifuzive".

Në paragrafin (3) fjalët: "mjetet nga taksa radiodifuzive" zëvendësohen me fjalët: "mjetet për financim të veprimtarisë radiodifuzive".

Neni 4

Titulli i kapitullit VII ndryshohet si vijon: "MJETET PËR FINANCIM TË VEPRIMTARISË RADIODIFUZIVE".

Neni 5

Titulli para nenit 135 ndryshohet si vijon:

" Mjete për financim të veprimtarisë radiodifuzive".

Neni 6

Neni 135 ndryshohet si vijon:

"(1) Mjetet për mbulimin e shpenzimeve për krijimin dhe emetimin e programeve dhe për zhvillimin teknik dhe teknologjik të shërbimit radiodifuziv publik, për mirëmbajtjen, përdorimin dhe zhvillimin e rrjetit radiodifuziv publik dhe për punën e Agjencisë, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë do të ndahen 0,5 % për realizimin e qëllimeve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Nga mjetet e parapara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni financohen shfrytëzuesit në vijim:

- NP Radiotelevizioni i Maqedonisë,
- NP Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe
- Agjencia.

Neni 7

Neni 136 shlyhet.

Neni 8

Neni 137 shlyhet.

Neni 9

Neni 138 shlyhet.

Neni 10

Neni 139 shlyhet.

Neni 11

Në nenin 140 paragrafi (1) fjalët: “Mjetet nga taksa e arkëtuar radiodifuzive” zëvendësohet me fjalët: “Mjetet për financimit të veprimtarisë radiodifuzive”.

Paragrafët (2) dhe (3) shlyhen.

Paragrafi (4) behet paragraf (2).

Neni 12

Ne nenin 143 paragrafi (3) fjalët: “nga taksa radiodifuzive” zëvendësohet me fjalët: “nga mjetet për financim të veprimtarisë radiodifuzive”.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.